



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Emërtimi i Modullit: PËRKTHIM TEKNIK NË FUSHËN E SË DREJTËS CIVILE

(KSHK 7, Kualifikim për të nxënësit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

Programi i Formimit të Vazhduar : “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

Lloji i Trajnimit: Trajnim i drejtpërdrejtë në prezencë / online

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: “Gjuha e burimit” anglisht, frëngjisht, italisht, të huajisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

“Gjuha e synuar” anglisht, frëngjisht, italisht, të huajisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip

Kohëzgjatja e programit të modullit: 30 orë

Mënyra e zhvillimit: Trajnim i drejtpërdrejtë në prezencë / online

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Programi përmban trajtimin e temave që lidhen me përkthimin në fushën e të Drejtës Civile nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Në trajnim do të trajtohen tekste me terminologji nga fusha e së drejtës civile. Pjesëmarrësit pasi të marrin bazat e së drejtës civile do jenë në gjendje të dallojnë burimet e së drejtës dhe subjektet e së drejtës, si dhe të përvetojnë terminologjinë përkatëse përmes ushtrimeve dhe përkthimeve konkrete, si në fushën e së drejtës materiale, asaj familjare apo të drejtës së trashëgimisë.

Moduli synon t’u japë përfituesve njohuri teorike dhe praktike nga fusha e së drejtës civile dhe t’i aftësojë ata në gjetjen e zgjidhjeve në rastet problematike të mungesës së barasvlerësve krijuar jo vetëm për shkaqe gjuhësore, por edhe prej ndryshimeve që çdo e drejtë sjell me vete.

OBJEKTIVAT E MODULIT:

Objektivat e përgjithshme:

Ky modul synon:

- të japë njohuri bazë krahasuese mbi të drejtën civile shqiptare dhe të vendeve të huaja.
- të ofrojë njohuritë e duhura mbi nivelet e ndryshme të zbërthimit të teksteve nga e drejta civile;
- të ndihmojë në ngritjen e një fjalori bazë me terma të së drejtës civile;
- të prezantojë dhe ofrojë teknika dhe modele përkthimi në fushën e së drejtës civile;
- të aftësojë të interesuarit në përkthimin në fushën e së drejtës civile